

Photo: Unsplash/ Besant Ademir, 2020

Kosova*

Pasqyra E Fakteve Të Vendit 2024



Federal Office
for Migration
and Refugees



* Referencat në Kosovë do të kuptohet se janë në kontekstin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244/1999

Botues

Organizata Ndërkombëtare për Migracion (IOM) Gjermani

Charlottenstraße 68
10117 Berlin
Gjermani
T. +49 911 43 000
F. +49 911 43 00 260

iom-germany@iom.int
www.germany.iom.int

Ky projekt është i financuar nga Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF).



Informacioni që përmbahet në këtë Pasqyrë të Fakteve të Vendit është hulumtuar me qëllimet më të mira dhe me kujdes. Sidoqoftë, IOM-i Gjermani nuk mban asnjë përgjegjësi ose detyrim për ndonjë gabim ose lëshim. Për më tepër, IOM-i Gjermani nuk mund të mbajë përgjegjësi për konkluzionet ose vendimet e marra bazuar në informacionin e dhënë në këtë Pasqyrë të Fakteve të Vendit. Për informata të mëtejshme mbi kthimin vullnetar dhe riintegrimin, ju lutemi vizitoni portalin e informacionit www.ReturningfromGermany.de, ose kontaktoni zyrën tuaj lokale për kthim dhe riintegrim.

Publikuar: Dhjetor 2024

Përmbajtja

1. Kujdesi Shëndetësor _____
2. Tregu i Punës _____
3. Strehimi _____
4. Mirëqenia Sociale _____
5. Arsimi _____
6. Fëmijët _____
7. kontakte _____
8. Me një Shikim _____
9. Virtual Counselling _____

1 Kujdesi Shëndetësor

Informacione të përgjithshme për kujdesin shëndetësor

Sistemi i Kujdesit Shëndetësor në Kosovë është i organizuar në tre sektorë që përfshijnë kujdesin shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) në Prishtinë është i organizuar në trembëdhjetë Qendra të Mjekësisë Familjare dhe pesëmbëdhjetë Njësi të Kujdesit Ambulator. Këto Qendra të Mjekësisë Familjare ofrojnë shërbime themelore të kujdesit parësor. Kujdesi dytësor shëndetësor është i decentralizuar në shtatë spitale rajonale, të cilët kanë secili deri në 500 shtretër. Rajonet e Ferizajt, Gjakovës, Gjilanit, Pejës dhe Prizrenit, kanë secili nga një spital rajonal, ndërsa rajoni i Mitrovicës ka dy: një në Mitrovicën e Veriut dhe tjetri në Mitrovicën e Jugut. Prishtina nuk ka spital rajonal, porse përdor Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) për shërbimet e kujdesit shëndetësor. Ka edhe shërbime në shtëpi të ofruara për grupe të cënueshme që vështirë se mund të arrijnë në ambientet e kujdesit shëndetësor. Kujdesi tretësor shëndetësor sigurohet nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, e vendosur në Prishtinë. QKUK është institucioni kryesor shëndetësor publik duke përfshirë 15 klinika nën mbikëqyrjen e vet.

Krahas institucioneve shëndetësore publike, ka shumë klinika private dhe spitale në të gjithë Kosovën. Spitalet private ofrojnë kohë më të shkurtër të pritjes sesa në një spital publik dhe janë më të pajisura për të ofruar kujdes të personalizuar, shtrim afatshkurtër në spital, shërbime të urgjencës, shërbime kirurgjikale të përgjithshme dhe të specializuara. Institucionet private vazhdojnë të jenë një alternativë e preferuar ndaj institucioneve të shëndetit publik për një larmi arsyes. Për personelin e kujdesit shëndetësor, institucionet private janë një mënyrë

për të shtuar të hyrat e tyre nga sektori publik. Për pacientët, institucionet private nuk kërkojnë referime nga Qendrat e Mjekësisë Familjare, dhe kështu pacientët mund të kalojnë drejtpërdrejt në kujdes të specializuar.

Disponueshmëria e pajisjeve mjekësore dhe mjekëve

Në Kosovë, sistemet publike dhe private supozohet të funksionojnë veçmas dhe në mënyrë të pavarur. Sipas ligjit, mjekët e kanë të ndaluar të referojnë pacientë nga sektori publik në sektorin privat. Në praktikë, referime të tilla ndodhin rregullisht. Është e zakonshme që mjekët të punojnë në të dy sektorët në të njëjtën kohë. Edhe pse sigurimi shëndetësor publik është një e drejtë për të gjithë qytetarët, në Kosovë kjo ende nuk është bërë realitet. Në mungesë të sigurimit shëndetësor publik, disa kompani kanë filluar të ofrojnë sigurime shëndetësore private. Sidoqoftë, këto nuk janë mjaft të përbalueshme për popullatën e gjerë në Kosovë.

Pranimi në objektet mjekësore

Personat duhet së pari të kontaktojnë institucionet në nivelin parësor të sistemit shëndetësor, Qendrat e Mjekësisë Familjare ose Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare. Nëse nevojitet përcjellje, duhet shkuar në spitalet rajonale të vendosura në rajonet kryesore të vendit. Nëse shërbimet nuk janë të disponueshme në institucionet e nivelit dytësor, pacientët do të marrin një rekomandim me shkrim për të hyrë në nivelin tretësor - Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë. Personat e cënueshëm janë në kategoritë që përjashtohen nga pagesat. Këto kategori përfshijnë veteranët e luftës, përfituesit e ndihmës sociale dhe fëmijët. Kujdesi shëndetësor sigurohet përmes organizimit dhe zbatimit të aktiviteteve mjekësore nga institucionet

1 Kujdesi Shëndetësor

shëndetësore të sektorit publik, privat dhe të përzier. Aktiviteti mjekësor është i organizuar në mënyrë që të sigurojë kujdes të duhur dhe të suksesshëm shëndetësor për qytetarët në rrethana normale dhe të jashtëzakonshme. Llojet e sigurimeve mjekësore për qytetarët dhe të gjitha komunitetet në Kosovë janë:

Sigurimi themelor mjekësor - është një sigurim i detyrueshëm për të gjithë qytetarët, të cilët janë në marrëdhënie zyrtare të punës, dhe për personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me ligjin.

Sigurimi privat mjekësor - është një sigurim vullnetar i qytetarëve, ku sigurimi sigurohet nga qytetarët dhe/ose nga punëdhënësit në organizatat e themeluara në përputhje me ligjin. Kostot e pjesëmarrjes në ndërmarrjet private janë 35 deri në 45, varesisht nga pako që ata zgjedhin dhe cka ofron ajo pako. Pacientët mund të zgjedhin kompaninë ku dëshirojnë të regjistrohen për sigurim mjekësor.

Disponueshmëria dhe kostot e barnave

Barnatoret dhe objektet e kujdesit shëndetësor të Kosovës mbështeten shumë tek pajisjet dhe medicinale dhe barnat e importuara. Sa i përket kostove, pacientët duhet të paguajnë për shërbimet si më poshtë: në sektorin parësor, nëse pacientët nuk posedojnë ndonjë përjashtim, ata duhet të paguajnë tarifën e shërbimit bazë deri në 2 euro. Ndërsa në sektorët dytësor dhe tretësor, tarifat e shërbimit varen nga lloji i trajtimit dhe institucioni mjekësor. Institucione të ndryshme marrin tarifa të ndryshme shërbimi. Sistemi i sigurimeve shëndetësore nuk është zbatuar ende. Barnat esenciale supozohet të jenë në dispozicion falas në çdo qendër të kujdesit shëndetësor publik, por ndodh shpesh që të mos ketë furnizim dhe të mos jenë të disponueshme në klinikat publike. Barnatoret e pavarura mund të

jenë në gjendje t'i importojnë barnat e nevojshme, por ka të ngjarë të jenë të shtrenjta.

Qasja për të kthyerit

Pranueshmëria dhe kërkesat: Ngjashëm me të gjithë banorët në Kosovë, të kthyerit kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet falas. Në rast të cënueshmërisë, ata gjithashtu bien në kategoritë që përjashtohen nga pagesat.

Personat e riadhesuar me çështje mjekësore, kanë të drejtë të përfitojnë nga buxheti i ri-integrimit për mbulimin e kostove të tyre në qoftë se këto trajtime nuk jepen nga institucionet publike dhe mbulimi i shpenzimeve për mjekimet që nuk gjenden në listën esenciale.

Procedura e regjistrimit: Nuk kërkohet regjistrim, përveç për të provuar statusin përkatës, siç janë të papunët, fëmijët, veteranët e luftës dhe përfituesit e ndihmës sociale. Këto kategori përjashtohen nga pagesat dhe pjesëmarrja.

Kërkesës për trajtim mjekësor duhet t'i bashkëngjitet raporti i Mjekut Specialist dhe dokumentet e tjera të nevojshme nga Institucioni Publik Shëndetësor. Trajtimi mjekësor mund të sigurohet deri në dymbëdhjetë (12) muaj nga data e riadhesimit.

Dokumentet e kërkuara: Kur marrin shërbime mjekësore në sektorin publik, pacientët duhet të paraqesin dokumentet e tyre sa herë që marrin shërbime mjekësore për të provuar se i përkasin njërës prej këtyre kategorive. Dokumentacioni i tillë mund të përfshijë një certifikatë të papunësisë, dokument të ndihmës sociale, ose ndonjë dokument tjetër që vërteton cënueshmërinë e tyre.

2 Tregu i Punës

Informacione të përgjithshme mbi tregun e punës

Kosova është vendi më i ri në Evropë me popullsinë më të re. Bruto Prodhimi Vendor i Kosovës për kokë është më i ulët në rajon. Bazuar në një vlerësim paraprak nga Banka Botërore, BPV-ja e Kosovës u rrit me 4.17% në 2019 krahasuar me një vit më parë. Sidoqoftë, në raportin e saj të mëparshëm në Prill, banka paralajmëroi se zgjatja e masave të kufizimit të lidhura me COVID-19 përtej tremujorit të dytë kërkon një menaxhim të kujdesshëm makro-prudencial, pasi ato mund ta ngadalësojnë më tej rritjen në 2020. Në vitet e fundit, ekonomia është udhëhequr nga investimet publike në infrastrukturë dhe nga konsumi privat. Remitancat nga diaspora - e vendosur kryesisht në Gjermani, Zvicër dhe në vendet nordike - llogariten të përbëjnë rreth 17% të BPV-së dhe ndihma ndërkombëtare e donatorëve përbën rreth 10% të BPV-së. Me ndihmë ndërkombëtare, Kosova ka qenë në gjendje të privatizojë shumicën e ndërmarrjeve shtetërore. Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore në Kosovë është rreth 40%.

Përkundër potencialit të fuqisë punëtore, rritja ekonomike e Kosovës nuk është në gjendje të gjenerojë vende pune për tërë fuqinë aktive të punës që mbetet një burim i papërdorur i ekonomisë. Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Anketa e Tregut të Punës, shkalla e papunësisë tek të rinjtë mbetet ende një çështje e pazgjidhur për ekonominë e Kosovës. Të hyrat mesatare sillen mes 300-400 euro në muaj, ndërsa paga minimale është 200 euro. Moshë ligjore e punës në Kosovë është 18 vjeç, e cila konsiderohet në të njëjtën kohësi moshë ligjore edhe në përgjithësi, kurse

mosha e pensionit është 65 vjeç. Ekonomia e Kosovës ka treguar përparim në kalimin në një sistem të bazuar në treg dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, por është ende shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe diaspora (remitancat) për ndihmë financiare dhe teknike. Me ndihmë ndërkombëtare, Kosova ka qenë në gjendje të privatizojë shumicën e ndërmarrjeve shtetërore. Shumica e popullsisë së Kosovës jeton në qyteza jashtë kryeqytetit Prishtinë. Bujqësia jo efiçente dhe e nivelit të mbijetesës është e zakonshme për shkak të ngastrave të vogla, mekanizimit të kufizuar, dhe mungesës së ekspertizës teknike. Sektorët ekonomikë premtues që vazhdojnë të punësojnë më shumë njerëz janë: tregtia me 17.0%; ndërtimtaria me 11.9%; arsimi me 11.3%; dhe prodhimi me 10.3%. Ndërkohë, sektorë të tjerë marrin pjesë me përqindjen më të ulët në punësim. Kosova është në vend të fundit në Ballkanin Perëndimor për sa i përket konkurrueshmërisë. Vendi ka probleme për sa i përket fuqisë punëtore të disponueshme. Konkurrueshmëria e ulët, siç identifikohet nga treguesit në raportin e konkurrueshmërisë globale, mungesa e informacionit në lidhje me tregjet e BE-së, dhe nevoja për rrjetëzim, standardizim, licencim dhe akreditim. Sidoqoftë, Kosova ka vendosur prioritetet vijuese për të përmirësuar aftësinë konkurruese të vendit: përmirësimin e shkathtësive të punës përmes programeve të trajnimit dhe arsimit, përmirësimin e biznesit.

Gjetja e punësimit

Në Kosovë nuk ka ende skemë të përkrahjes së papunësisë. Zakonisht, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës së bashku me organizatat ndërkombëtare u ofrojnë punëkërkuarve

2 Tregu i Punës

ndihmë për të gjetur punë përmes masave aktive të tregut të punës dhe programeve të ndryshme të praktikës profesionale me pagesë. Përmes këtyre programeve, ata mund të marrin një pagë shumë modeste prej 150 eurosh.

Punëkërkuarët e riadhesuar që përmeshin kërkesat për punësim kanë të drejtë të aplikojnë për pjesëmarrje në subvencionimin e punësimit. Subvencioni i punësimit menaxhohet nga MLSW.

Ndihma për papunësinë

Mënyra për të pasur qasje në njoftimet për punë është përmes ueb faqeve dhe për sektorin publik në gazetatat kombëtare, por edhe në tabelat e informacionit të institucioneve ose agjencive që publikojnë vendet e lira të punës. Disa nga ueb faqet më të zakonshme për punëkërkuarët janë:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës: <https://apr.krs-gov.net/en-US/Home/Index>
- Indeed: <https://www.indeed.com/q-Kosovo-jobs.html>
- Portal pune: <https://www.portalpu-ne.com/>
- Gjirafa: <https://gjirafa.com/>
- Kosova job: <https://kosovajob.com/home>

Arsimi dhe aftësimi i mëtijshëm

Agjencia e Punësimit e ka pranuar nevojën për ta kuptuar më mirë rolin e Qendrave të Aftësimi Profesional për adresimin e sfidës së papunësisë së lartë, si dhe rolin e qendrave për pajisjen e përfutësve me shkathtësi përkatëse për tregun e punës. Qendrat e Aftësimi Profesional në Kosovë janë në dispozicion për të lehtësuar qasjen e punëkërkuarve në agjencitë e punësimit. Këto qendra janë të vendosura në komuna të ndryshme si p.sh.

Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Gjakovë,

Gjilan, Ferizaj, dhe Skënderaj. Në kontekstin e reformave të arsimit dhe aftësimi profesional në Kosovë, ka disa qendra të kompetencave që ofrojnë ekspertizë për projekte të ndryshme ose mbështetje të programeve në fusha të shumta të biznesit. Dy qendra të kompetencave janë funksionale në Malishevë dhe Skënderaj. Në planin afatgjatë, kjo duhet të rrisë aftësinë konkurruese të bizneseve dhe të ulë papunësinë, veçanërisht tek të rinjtë. Trajnimi profesional i disponueshëm përfshin kontabilitet, saldime me hark dhe gaz, parukeri, elektrikist, rrobaqepësi, trajnimin për TI, ndërtimtari, hidraulik.

Qasja për të kthyerit

Pranueshmëria dhe kërkesat: Të gjithë personat mbi 18 vjeç të aftë për të punuar. Integrimi i personave të riadhesuar në tregun e punës bëhet përmes Shërbimeve Publike të Punësimit (PES), duke përfshirë masat aktive të tregut të punës: trajnim profesional; trajnim në punë; subvencionimi i punësimit; dhe vetë-punësimin dhe nxitjen e sipërmarrjes.

Procedura e regjistrimit: Kur regjistrohen në këto zyra, të kthyerit duhet të dorëzojnë letërnjoftimin, diplomat dhe certifikatat e nevojshme.

Dokumentet e kërkuara: Regjistrimi është i mundshëm në zyrat e punësimit. Të kthyerit mund të vizitojnë zyrën më të afërt dhe duhet të deklarohen si punëkërkuar. Në këtë rast, ata do të jenë në listën e Sistemit të Menaxhimit të Punësimit. Ata u nënshtrohen procedurave të zakonshme si një intervistë.

Vetëm një nga anëtarët e familjes së personave të riadhesuar mund të përfitojë nga programi i vetë-punësimit.

3 Strehimi

Informacione të përgjithshme për strehimin

Si banesat ashtu edhe shtëpitë janë gjerësisht të disponueshme në qytetet e Kosovës, dhe kryesisht në kryeqytetin Prishtinë. Qiraja në zonat rurale është shumë e ulët dhe pothuajse nuk ekziston. Kohët e fundit ka dëshmi të forta të migrimit të brendshëm në Kosovë, lëvizjet nga popullata rurale, kështu që kërkesat janë të larta në kryeqytet dhe zonat urbane. Këto kërkesa i mbajnë çmimet e qirasë shumë të larta krahasuar me të hyrat. Qiratë e përafërt mujore pa përfshirë shërbimet komunale, në Prishtinë shkojnë nga 150 në 500 euro.

Garsoniere/banesë: 150-200 euro;

Banesë një dhomëshe: 200-250 euro;

Banesë dy dhomëshe: 250-350 euro;

Banesë tre dhomëshe: 300-500 euro

Kohët e fundit, qiraja mesatare mujore e vlerësuar është 200 euro, ndërsa në qytetet e tjera çmimi është më i ulët se në Prishtinë, afërsisht 60-80 euro. Brenda qytetit, në Prishtinë, çmimi mesatar i blerjes për 1 m² i një banese është mes 800 dhe 900 euro. Kosova ka tarifën më të ulët bruto për energji për familjet dhe ka pjesën më të vogël të tatimeve dhe detyrimeve për energji elektrike në të gjithë Evropën. Përditësimi i Eurostat për Bashkimin Evropian dhe rrethinat e tij tregoi se në Kosovë norma ka rënë 4.4% nga viti në vit, duke kapur 6.1 euro në 2020, që do të thotë se familjet atje paguajnë më së paku për energjinë elektrike në Evropë.



Photo: Unsplash/ Edin Murati, 2018

Gjetja e akomodimit

Banesat dhe shtëpitë me qira mund të gjenden përmes ueb faqeve dhe agjencive të ndryshme në të gjithë vendin. Ueb faqet kryesore përfshijnë:

- <https://www.merrjep.com/shpalljet/vendbanime/banesa/prishtine>
- <http://www.kosova-immobilien.com/>
- <http://www.kosova-immobilien.com/partners/prona-net/>
- <https://gjirafa.com/Top/Patundshmeri>
- <https://www.facebook.com/groups/175681372461525/>
-

3 Strehimi

Grantet sociale për strehim

Sipas legjislacionit, sigurimi i banesave sociale është përgjegjësi e nivelit komunal. Komunave u kërkohet të hartojnë një program tre-vjeçar të bazuar në nevojat për strehim dhe identifikimin e tokës në dispozicion për ndërtim, dhe më pas të kërkojnë një kontribut financiar nga qeveria qendrore ose komuniteti i donatorëve për ta zbatuar atë. Sidoqoftë, mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të ndara në nivelin komunal, nuk u lejon institucioneve të nivelit lokal dhe qendror të krijojnë një pasqyrë të qartë dhe të saktë të shkallës së nevojave për strehim social. Në shtator 2010, Qeveria e Kosovës themeloi Fondin e Riintegritimit për të mbështetur riintegrimin e qendrueshëm të qytetarëve të riatdhesuar të Kosovës. Fondi i Riintegritimit për Personat e Riatdhesuar ofron mbështetje gjithëpërfshirëse për migrantët e kthyer, përmes ndihmës për strehimin e përkohshëm dhe afatgjatë, punësim, krijimin e bizneseve të vogla, trajnim profesional dhe trajnim gjuhësor për fëmijët.



Photo: IOM / 2017

Në mënyrë të ngjashme, shërbimet kyçe për personat e zhvendosur dhe të kthyerit përfshijnë rindërtimin e shtëpive (rindërtim i plotë ose riparime të vogla), mbështetje me materiale ndërtimore dhe mobilje themelore, aktivitete që krijojnë të hyra dhe punësim.

Qendrat e Punës Sociale janë siguruesit kryesorë të granteve sociale për strehim, përtej mbështetjes së rastit të ofruar nga disa OJQ. Sidoqoftë, këto qendra ndihmojnë vetëm ata persona që marrin pjesë në skemën e ndihmës sociale.

Qasja për të kthyerit

Objekti i strehimit të përkohshëm: Në Kosovë qeveria ofron strehim të përkohshëm deri në një javë për personat me mbështetje të kufizuar nga familjet e tyre. Ata ka të ngjarë të jenë personat me nevojat më të rëndësishme.

Strehimi social: Qendrat e Punës Sociale janë siguruesit kryesorë të granteve sociale për strehim, përtej mbështetjes së rastit të ofruar nga disa OJQ. Sidoqoftë, këto qendra ndihmojnë vetëm ata persona që marrin pjesë në skemën e ndihmës sociale, këta janë njerëz me nevojë ekstreme për mbështetje.

Dokumentet e nevojshme që vërtetojnë pronësinë e pronës, dokumentet e tjera të dëmeve të pronës dhe shkatërrimit dhe pëlqimin e komunës për renovim ose rindërtim dhe konfirmimin se personi nuk është përfitues i ndonjë programi tjetër më parë, do t'i bashkëngjiten kërkesës.

4 Mirëqenia Sociale

Sistemi i mirëqenies sociale

Mbështetja sociale në Kosovë kryesisht përfshin ndihmë monetare mujore për familjet e varfra, personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, pensionistët që gëzojnë të drejtën e pensionit në përputhje me ligjet në fuqi, dhe kategoritë e invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Në mënyrë që të marrin ndihmë sociale, aplikantët duhet të paraqiten në Qendrat e Punës Sociale dhe të kontrollojnë nëse mund të kenë të drejtë për këtë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Qendrat janë të vendosura në çdo komunë të Kosovës. MLSW në bashkëpunim me komunën përkatëse ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar, brenda periudhës më të shkurtër të mundshme, personat e riatdhesuar në nevojë për të përfutur nga skemat sociale, në përputhje me ligjin. Personat e riatdhesuar me kushte të rënda ekonomike, të cilët për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm nuk mund të aplikojnë për përfitime nga ndihma sociale, të njëjtët kanë të drejtë për ushqime, higjienë dhe paketa materiale 3 mujore. Aplikantët duhet të vizitojnë qendrën më të afërt të mirëqenies sociale për informacion të mëtejshëm dhe për dorëzimin e dokumenteve të tyre. Informacionet lidhur me shërbimet komunale do t'u jipen personave të riatdhesuar menjëherë pas aritjes në komunën e destinacionit.

Skema e ndihmës sociale siguron ndihmë financiare të përkohshme për familjet që janë në varfëri dhe zgjidhen në përputhje me kriteret e përkrahura në ligj dhe burimet e alokuara për këtë qëllim nga buxheti i Kosovës. Për të realizuar të drejtën për ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe duhet të plotësojnë kushtet për përfshirje në njërin nga kategoritë e përcaktuara me

ligj. Përfshirë, përfituesit e ndihmës sociale mund të jenë shtetas të huaj nëse: janë me banim në Kosovë, persona në cilësinë e azilkërkuar, persona refugjatë dhe persona që gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese. Lidhur me procesin e aplikimit për ndihmë, kur personat kthehen vullnetarisht, ata mund të aplikojnë drejtpërdrejt për Ndihmë për Riintegrim në Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitetet; në këtë rast ata do të regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Rasteve (SMR) dhe do të aplikojnë për ndihmë për riintegrim. Kur personat kthehen me forcë në Kosovë, Departamenti i Migracionit dhe Azilit informohet për ardhjen e tyre nga vendi dërgues dhe ia jep këtë informacion Departamentit për Riintegrimin të Personave të Riatdhesuar (DRPR). DRPR informon komunën e origjinës përmes Sistemit të Menaxhimit të Rasteve dhe koordinatorëve rajonalë. Ekipi i DRPR-së në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës pranon personat e riatdhesuar pas mbërritjes së tyre, vlerëson nevojat e tyre të menjëhershme, siguron ndihmën e nevojshme (banimin dhe akomodimin e përkohshëm, shërbimet shëndetësore, transportin në komunën e origjinës) dhe regjistrimin e tyre në SMR. Pas mbërritjes në komunë, stafi i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete e kontakton personin e rikthyer për të siguruar informacion në lidhje me ndihmën në dispozicion dhe për të bërë një vlerësim më të plotë të nevojave. Komunitet ofrojnë gjithashtu shërbime bazë komunale si: këshillim, regjistrim civil, strehim, arsimim, mirëqenie sociale dhe punësim, kujdes shëndetësor dhe trajtim mjekësor për personat e riatdhesuar sipas legjislacionit përkatës.

Personi i riatdhesuar plotëson formularin e aplikimit për ndihmë dhe ia paraqet kërkesën Komisionit Qendror të Riintegritimit (KQR). Kërkesa pastaj

4 Mirëqenia Sociale

shqyrtohet brenda periudhës së specifikuar në Rregulloren në fuqi dhe nëse është e suksesshme, ndihma jepet. Në disa raste, personat e riatdhesuar mund të përfitojnë nga programet e donatorëve për 'kthim vullnetar' të financuara nga organizata të tilla si IOM.

Qasja për të kthyerit

Pranueshmëria dhe kërkesat: Qytetarët e Kosovës që kanë të drejtë të përfitojnë nga pensioni bazë i Kosovës, ndërsa pensioni i kontributeve është për ata që kanë punuar dhe kontribuar në fondin e pensionit.

Dokumentet e kërkuara: Letërnjoftim (pension bazë), certifikatë lindje dhe diploma e arsimit (skema e kontributeve)

Sistemi pensional

Pensionin bazë i moshës - pensioni minimal i rregullt mujor u paguhet të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës, pavarësisht nëse ata kanë qenë të punësuar apo jo, dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Pensioni bazë i moshës u paguhet të gjithë personave që janë shtetas të përhershëm të Republikës së Kosovës, posedojnë dokumente identifikimi dhe kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç. Shuma mujore e këtij pensioni është 90 euro

Grupet e cënueshme

Rastet e njohura të cënueshme në Kosovë janë:

Individët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas (RAE) janë të diskriminuar në gjithçka dhe janë privuar gjerësisht në të gjitha dimensionet e varfërisë, dhe pakicat e tjera të cilët janë të privuar për

Qasja për të kthyerit

Pranueshmëria dhe kërkesat: Personat mbi 18 vjeç, me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të paafte për të punuar; Invalidë Personat mbi 65 vjeç; Prindërit me të paktën një fëmijë nën moshën 15 vjeç. Familjet me një person të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç

Procedura e regjistrimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentin e të qenit i papunë i cili lëshohet nga Zyrat e Punësimit në komunën përkatëse.

Dokumentet e kërkuara: Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës, certifikatat e lindjes të të gjithë anëtarëve të familjes, dhe deklarata e njësisë familjare.

Të miturit e pashoqëruar

Të moshuarit e vetmuar janë ndër grupet më të cënueshme në shoqëri, në të njëjtën kohë është grupi që ka më shumë nevojë për kujdes, pasi situata të ndryshme i kanë bërë të jetojnë vetëm dhe të harruar nga shoqëria dhe sistemi i kujdesit social shtetëror;

Viktimat e trafikimit;

Personat me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të cënueshëm - shumica e tyre mbështeten te familja e tyre si për mbështetje financiare ashtu edhe për ndihmë në aktivitetet e përditshme.

Qendrat e Punës Sociale dhe disa OJQ janë kontribuuesit kryesorë që mbështesin dhe ofrojnë ndihmë për grupet e cënueshme në Kosovë.

5 Arsimi

Informacione të përgjithshme mbi arsimin

Sistemi i arsimit parashkollor është i ndarë në tre nivele: Kopshti i fëmijëve (për fëmijët e moshës 1-2 vjeç), Kopshti i fëmijëve (për fëmijët e moshës 3-4 vjeç), dhe klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5 vjeç). Sipas ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, arsimi fillor (1-5 klasë) dhe arsimi i mesëm i ulët janë të detyrueshëm për të gjithë. Arsimi i detyrueshëm fillon kur fëmija mbush 6 vjeç (mosha minimale e arsimit të detyrueshëm). Sipas këtij ligji, arsimi në institucionet arsimore të financuara nga publiku është falas. Arsimi i mesëm i ulët është faza e dytë e arsimit të detyrueshëm që përfshin klasat nga 6 deri në 9, për nxënësit nga 12 deri në 15 vjeç. Arsimi në shkollat fillore në Kosovë zhvillohet në katër gjuhë: shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht. Arsimi i mesëm i lartë është i organizuar në arsimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Arsimi i mesëm i lartë zgjat 3 ose 4 vjet në varësi të kurrikulës arsimore të hartuar nga Ministria e Arsimit. Të gjithë nxënësit kanë të drejtë ta ndjekin këtë nivel mbi baza vullnetare. Arsimi i mesëm i lartë ndahet në dy kategori: arsimi i përgjithshëm dhe ai profesional. Në përputhje me ligjin për arsimin, të drejtat për arsim special në Kosovë janë për ata fëmijë që nuk kanë ose nuk janë në gjendje të kenë arsim normal. Në Kosovë, ekzistojnë gjithsej 7 shkolla për arsim special. Librat për arsimin e detyruar deri në klasën e pestë janë falas.

Kostot, kreditë dhe bursat

Nuk ka tarifa të shkollimit në shkollat publike fillore dhe të mesme, përveç nivelit të arsimit të lartë dhe në institucionet private në të gjitha nivelet. Bursat e komunave janë në dispozicion të



Aprovimi dhe verifikimi i diplomave të huaja

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është përgjegjës për njohjen e diplomave të huaja. Përgjegjësitë e tij janë mbikëqyrja e kualifikimeve kombëtare së bashku me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjencinë për Akreditim dhe organe të tjera profesionale të aprovuara për këtë qëllim nga qeveria, dhe në veçanti për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe diplomave të huaja.

5 Arsimi

Koha e dorëzimit është deri në 10 ditë; tarifa 30 EUR për diplome bachelor dhe 50 EUR për diplome të masterit MA.

Qasja për të kthyerit

Procedura e regjistrimit: Të gjithë fëmijët e riatdhësuar kanë të drejtë të ndjekin shkollimin në shkollat adekuate në Kosovë. Për regjistrimin e fëmijëve, para së gjithash, prindërit duhet të paraqesin kërkesën në Ministrinë e Arsimit. Vendimi përfundimtar, i cili merret nga Ministria, i detyron të gjitha shkollat të pranojnë fëmijët brenda të gjitha komunave në Kosovë.

Dokumentet e kërkuara: Certifikate lindje; certifikatat dhe diplomatat duhet të pranohen, dëshmi nga shkolla që konfirmojnë se fëmija ka ndjekur klasat e mëparshme.





Situata e përgjithshme e fëmijëve dhe foshnjave

Varfëria mbetet një realitet i ashpër për shumë në Kosovë, dhe përqindjen e fëmijëve që jetojnë në varfëri vlerësohet rreth 23%, përfshirë më shumë se 7% që jetojnë në varfëri ekstreme. Të jetosh në varfëri është shkaku kryesor i shumë pasojave negative për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, përfshirë punën e fëmijëve, martesat e fëmijëve, qasje më të ulët në shërbime dhe rezultate më të dobëta sociale. Varfëria në Kosovë prek në mënyrë disproporcionale gratë, fëmijët, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara dhe popullatat rurale. (Grupi i Bankës Botërore, 2019). Në veçanti, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas (RAE) kanë shkallë më të ulët të frekuencimit të shkollës, më pak mundësi punësimi dhe ka më shumë të ngjarë të jenë në

varfëri. Për fëmijët me aftësi të kufizuara, pengesat mbeten në formën e qasjes së kufizuar në arsimin adekuat, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet e rehabilitimit, dhe qasjen pa pengesa në objektet dhe shërbimet publike. Qasja në arsimin adekuat përfshin hapësira të qasshme dhe gjithëpërfshirëse të të nxënit, disponueshmërinë e mësimeve dhe asistentëve të trajnuar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, dhe dispozita për adresimin e barrierave të tjera si transporti, qasja në pajisjet ndihmëse, dhe tualetet adekuat. Në mënyrë të ngjashme, fëmijët në dekadën e dytë të jetës hasin vështirësi në ballafaqimin me sukses me tregun kompleks të punësimit për shkak të problemeve me cilësinë, rëndësinë dhe gjithëpërfshirjen e sistemeve arsimore.

Aktorë (jo) qeveritarë që merren me mirëqenien dhe të drejtat e fëmijëve

Këta aktorë joqeveritarë punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me misionin e përbashkët për të avokuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve në Kosovë dhe janë të vendosur në Prishtinë

- Save the children në Kosovë: <https://kosovo.savethechildren.net/>
- Programi i UNICEF-it në Kosovë: <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/>
- SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë: <https://www.sos-childrensvillages.org/where-we-help/europe/kosovo>
- Terre des hommes në Kosovë: <https://www.tdh.ch/en/our-interventions/kosovo>
- KOMF- Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve: <http://www.komfkosova.org/?lang=en>

Objektivat kryesore të këtyre OJQ-ve janë: përmirësimi i miratimit të ligjeve dhe politikave për fëmijët; monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe politikave kombëtare për fëmijët; sensibilizimi dhe mobilizimi i autoriteteve përkatëse shtetërore si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror, sensibilizimi i ofruesve të shërbimeve dhe aktorëve të tjerë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve; ngritja e vetëdijes së opinionit të gjerë për të gjitha çështjet që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve; rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të gjitha grupeve të tjera që janë të ekspozuara ndaj shkeljes së të drejtave të fëmijëve; krijimi i hapësirave për të zhvilluar praktikën më të mirë në fushën e të drejtave të fëmijëve.

7 Kontakte

Ministria për Komunitete dhe Kthim

Shërbimet për kthim dhe riintegrim
Personi kontaktues: Valbona Gashi Sheshi Nëna Terezë 10000, Fushë Kosovë, Kosovë
+383 200 16 502
valbona.r.gashi@rks-gov.net

Zyra Komunale për Kthim dhe Riintegrim

Shërbimet për kthim dhe riintegrim
Personi kontaktues: Snezana Nesterovic
Rr. Bedri Gjinaj, 40000, Mitrovicë, Kosovë Snezana.Nesterovic@rks-gov.net
+383 28 530 366

Terre des Hommes Kosovë OJQ

Personi kontaktues: Pajtim Zeqiri Rrustem Statovci Nr. 11, Prishtinë, Kosovë
kos.office@tdh.c
+383 44 248 148www.website.org

Koordinator rajonal i Zyrës për kthim dhe riintegrim, Gjilan
Shërbimet për kthim dhe riintegrim
Personi kontaktues: Astrit Bajrami Bulevardi i Pavarësisë, 60000, Gjilan, Kosovë
info.gjilani@rks-gov.net
+383 44 480 785

SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
Mirëqenia e Fëmijëve
Personi kontaktues: Nezahate Salihu Ramadani
Mat1,Rr.B Obj.Residio-3 HY.A. Nr.26, 10000 Prishtinë, Kosovë
info@soskosova.org
+383 38 749 887

Caritas Kosova OJQ

Personi kontaktues: Shkumbin Arifi Shën Nënë Tereza Nr. 3 Kisha Katolike 70000, Ferizaj, Kosovë
info@caritaskosova.org
+383 49 866 788

Koordinator rajonal i Zyrës për kthim dhe riintegrim, Ferizaj
Shërbimet për kthim dhe riintegrim
Personi kontaktues: Driton Halili, Dëshmorët e Kombit 70000, Ferizaj, Kosovë
info.ferizaj@rks-gov.net
+373 44 783 722

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF)
Mbrojtja e fëmijëve
Personi kontaktues: Donjeta Kelmendi
Zenel Salihu, OB.1 hy.1 K.3 Nr.16, 10000 Prishtinë, Kosovë
info@childpact.org
+383 220287

Spitali rajonal

Shëndeti
Personi kontaktues: Dr. Afrim Cana - psikolog
Kosovë, Rajoni i Gjilanit, 60000, Gjilan, Kosovë
+383 44 154 452
afrimcana@yahoo.com

Zyra për Kthim dhe Riintegrim, Prizren

Shërbimet për kthim dhe riintegrim
Personi kontaktues: Islam Elshani Remzi Ademaj, 20000, Prizren, Kosovë
islam_elshani@yahoo.com
+383 38 200 44702

Save the Children Kosovë

Mbrojtja e fëmijëve
Personi kontaktues: Artan Behrami 1 Rruga Gazmend Zajmi, 10000, Prishtinë, Kosovë
scik@savethechildren.org
+383 44 115 510

Spitali Amerikan

Shëndeti
Personi kontaktues: Dr. Ideal Hoxha Adresa: Rruga Shkupi, Nr.25, 10000, Prishtinë, Kosovë
+383 49 933 934
hoxha.50@gmail.com

Klinika e Neurologjisë

Shëndeti
Personi kontaktues: Dr. Nexhmedin Shala
Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 10000, Prishtinë, Kosovë
+383 38 512 656
drnegjmedin_shala@hotmail.com

Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës

Risocializimi
Personi kontaktues: Dr. Shpend Haxhibeqiri
Adresa: Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 10000, Prishtinë, Kosovë
+383 38 600 005
drshpend@gmail.com

Klinika e Psikiatrisë

Shëndeti
Personi kontaktues: Dr. Shukrije Statovci, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 10000, Prishtinë, Kosovë
+383 44 199 464
shukrije.statovci@kolegjiuni-ver-si-edu.net

8 Me një Shikim

Masat që duhet të ndërmerren para kthimit

Dokumentet: I kthyeri duhet të kërkojë nga autoritetet gjermane të gjitha dokumentet që mund t'i nevojiten më vonë në vendin e origjinës. Dokumentet që ata duhet të kenë para se të hyjnë në Kosovë janë: certifikata e lindjes dhe dokumente të tjera të regjistrimit civil, diploma nga shkolla që kanë ndjekur në Gjermani, dhe certifikata të kurseve ose trajnimeve profesionale të ndjekura.

Transporti: Merrni informacion në lidhje me mbërritjen në aeroport dhe udhëtimin e ardhshëm.

Akomodimi: Gjeni strehim të përkohshëm. Në Kosovë qeveria ofron strehim të përkohshëm deri në një javë për personat me mbështetje të kufizuar nga familjet e tyre.

Shëndeti: Informacion shëndetësor, përfshirë imunizimin, sëmundjet dhe kushtet e rënda shëndetësore, dhe çdo informacion tjetër shëndetësor i rëndësishëm.

COVID-19: Duhet të merrni informacion në lidhje me rregullat dhe kufizimet ndaj COVID-19 dhe të veproni në përputhje me të.

Masat që duhet të ndërmerren menjëherë pas mbërritjes

Regjistrimi: I kthyeri duhet të regjistrohet. Regjistrimi duhet të kryhet pas kalimit të kontrollit kufitar në aeroport ose kalimit të kufirit tokësor.

Pritja: Pritja është në dispozicion në zyrën e pritjes për riintegrim pas mbërritjes së personave të riadhesuar. Zyrtarët e pritjes në aeroport i informojnë personat e riadhesuar për procesin e përgjithshëm të riintegrit.

Fëmijët: Fëmijët e lindur në Gjermani duhet të paraqesin certifikatën e lindjes të përkthyer të lëshuar nga autoritetet gjermane. Për personat mbi 18 vjeç, kërkohet pasaportë dhe letërnjoftim.

Arsimi: Bëni kërkesë për regjistrim në shkollë. Duhet të paraqiten diplomat dhe certifikatat.

Mirëqenia sociale: Bëni kërkesë për ndihmë sociale. Zyrat e ndihmës sociale janë në çdo komunë në të gjithë vendin. Mbështetje jepet vetëm personat e cenueshëm në nevojë dhe me kushte të dobëta.

Vende pune: Kontaktoni shërbimet që ofrojnë ndihmë për gjetjen e vendeve të punës. Së pari, i kthyeri duhet të shkojë personalisht dhe të regjistrohet si punëkërkuar dhe duhet të paraqesë një dokument identifikimi të lëshuar nga Qeveria e Kosovës

9 Virtual Counselling

Ndihma për migrantët në Kosovë

Projekti i Këshillimit Virtual zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Gjermani. Migrantëve që jetojnë në Gjermani dhe që po konsiderojnë kthimin, u jepet këshillim për kthim dhe riintegrim nga stafi i IOM-it në Kosovë. Personeli lokal i IOM-it mund të kontaktohet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze përmes mesazheve online.

Ky shërbim synon t'i fuqizojë migrantët që të kthehen me dinjitet, duke i informuar rreth opsioneve të ndryshme për kthim dhe riintegrim dhe programeve të ndihmës.



Kontaktoni Arifen në IOM Kosovë

WhatsApp: +383 49 968 523

Kohët e këshillimit: a hënë - a premte, ora 09:00 - 17:00 (MEZ)